

**V E N D I M**  
**Nr. 22/18, datë 23.10.2000**

**PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN LOKAL PRIVAT “TV 4+”**

SUBJEKTIT: Z.SHKËLQIM BYLYKBASHI

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr.8655, datë 31.07.2000 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.09.1998 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë””, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, njëzëri

**V E N D O S I:**

1. T’i japë subjektit, Z. SHKËLQIM BYLYKBASHI licencë duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv lokal privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj license.
2. Licensa, bashkëlidhur, përmban kushtet e licensës ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.